

EC

MA NDRYSHE

EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RICIKLO -

EKO KLUBI "LUCIANO MOTRONI"



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

CARITAS

Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

YENI

YOUTH
ENVIRONMENTAL
IMPACT



Të dashur lexues,

Kjo është seria e dytë e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i Shkollës së Mesme të Lartë "Luciano Motroni" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimitdhënësve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).



ROLI I BIODIVERSITETIT NË SIGURIMIN E ARSIMIT FILLOR NË MBARË BOTËN DHE BARAZISË GJINORE

Biodiversiteti ndikon mundësinë për t'u arsimuar dhe barazinë gjinore duke rritur kohën e shpenzuar nga gratë dhe fëmijët për kryerjen e disa detyrave në mirëmbajtjen e shtëpisë dhe kështu kohën e disponueshme për arsimim dhe aktivitete të tjera. Degradimi i ekosistemeve dhe humbja shoqëruese e biodiversitetit, shpesh rezulton që në shumicën e kohës është harxhuar për të grumbulluar burime të tilla si lëndë djegëse dhe ujë të pijshëm¹. Biodiversiteti gjithashtu duhet të luajë një rol kritik në sigurimin e ushqimit, i cili është i lidhur direkt me të dy kategoritë e arsimit dhe cilësisë së mësimdhënies.

Veç kësaj, mbrojtja dhe përdorimi i pandërprerë i burimeve të biodiversitetit ka qenë i lidhur ngushtë me prodhimin e shtuar të tokave bujqësore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme midis grave fermere, të cilat llogariten që sigurojnë kohët e fundit 60-80 % të gjithë prodhimin ushqimor në vendet e zhvilluara³. Sidoqoftë, këto gra shpesh mbeten pa u vënë re në vendim-marrje në mundësinë për të ndikuar mbi burimet e biodiversitetit kritike për mjetet e tyre të jetesës.

EFEKTI SERRË DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE


Efekti serë është pasojë e një çekuilibrimi të energjisë (nxehësisë) ndërmjet sasisë së nxehësisë që Toka merr nga Dielli dhe sasisë që ajo çliron sërish në hapësirë. Ngrohja globale ndodh si rezultat i emetimeve të tepërta të gazeve serë (GS), si dioksidi i karbonit, metani, klorofuorokarburet, oksidet e azotit dhe të tjera që thithin rrezatimin diellor dhe mbajnë nxehësinë. Me pak fjalë, efekti serë është ngrohja e pakontrolluar e atmosferës së Tokës. Djegia e lëndëve djegëse fosile (qymyri, nafta dhe gazi natyror) është burimi më i madh i emetimeve të gazeve serë.

Cilat janë zgjidhjet e mundshme?

Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë përfshijnë restaurimin e ekosistemeve natyrore (pyjet, kullotat, ligatinat dhe habitatet ujore), rritjen e infrastrukturës së gjelbër në qytete dhe mbjelljen e zonave të reja të pasuruara me lloje bimore që ofrojnë kushte më optimale për fotosintezën. Hulumtimet kanë treguar se aplikimi i ZBN-ve mund të zvogëlojë emetimet e gazeve serë me 30%, gjë që është e nevojshme për të stabilizuar ngrohjen globale në më pak se 2°C deri në vitin 2030.

[HTTPS://WWW.IUCN.ORG/SITES/DEFAULT/FILES/2023-05/CLIMATE-CHANGE-IN-12-PICTURES_ALBANIAN.PDF](https://www.iucn.org/sites/default/files/2023-05/climate-change-in-12-pictures_albanian.pdf)





DOKUMENTAR MJEDISOR ME EKO -KLUBET

Dokumentari mjedisor në "Kino Lumbardh" për 12 Eko - Klubet e Shkollave të Mesme të Rajonit të Jugut (Prizren, Rahovec, Malishevë dhe Mamushë). Ky aktivitet është pasuar me diskutim në mes anëtarëve të eko klubeve mbi çështjet mjedisore të trajtuara në dokumentar.

Gjatë këtij aktiviteti u shqyrtua se si veprimet tona të pakujdesshme ndaj natyrës çojnë drejt degradimit të planetit, ta bëjnë atë të pabanueshëm për miliona njerëz dhe si do të sjellin shkatërrimin e popullatave të biodiversitetit.

Ky aktivitet përveç njohurive të reja dhe aktivizimit të nxënësve për të ofruar zgjidhje të ndryshme mbi këto çështje, po ashtu kontribuoi edhe për shoqërimin e tyre duke ndarë mes vete përvojat për aktivitetet mjedisore që ata realizojnë në shkollat e tyre.




Starting point altitude:
 1515 m/asl
 Destination altitude:
 2170 m/asl
 Duration of the tour:
 5 hours
 Trail difficulty
 ★★☆☆☆



The Big Pine Trail
 Hiking Trail - 7183

DESCRIPTION
 21.8 km
 5 h
 Elevation difference: +938 m / -816 m
 Highest Point: 2212 m
 Lowest Point: 1413 m
 Starting Point: N 42° 10' 53.1" E 20° 56'
 End Point: N 42° 12' 41.0" E 20°
 Trail Markation:


AKTIVITETET E EKO-KLUBIT: DITA NDËRKOMBËTARE E ECJËS NË NATYRË






LIGJËRATË


PROMOVIMI I VLERAVE NATYRORE TË PRIZRENIT PËRMES TË RINJËVE





DITA BOTËRORE - "TRASHËGËMIA NATYRORE"






GARA "PROMOVIMI I VLERAVE NATYRORE TË PRIZRENIT"




■ Në kuadër të garës kreative "Promovimi i vlerave natyrore përmes të rinjëve të Prizrenit" SHMLM "Luciano Motroni" zuri vendin e parë.

■ Në garë morën pjesë nxënës - përfaqësues nga 5 shkolla të mesme të Prizrenit.

■ Tema e nxënësve të Shmlm „Luciano Motroni,, - Vlerat mjekësore të bimëve në Grykën e Lumbardhit të Prizrenit!



"VLERAT NATYRORE DHE RËNDËSIA E TË RINJËVE NË MONITORIMIN DHE RUAJTJEN E AMBIENTIT EKOLOGJIK NË KOMUNËN E PRIZRENIT"



EKO KLUBI "LUCIANO MOTRONI" RR. MEHMET PASHË DEVALLA – PRIZREN, KOSOVË

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".